



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritime Evropiane

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 23. 12. 2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Naser Rugova, Nait Hasani dhe Mursel Halili.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Propozimplanit të punës të Komisionit për Integritime Evropiane për vitin 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Propozimplanit të punës të Komisionit për Integritet Evropian për vitin 2010

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se Plani i punës i Komisionit për Integritet Evropian është hartuar nga eksperti Kaloyan Simeonova. Shtoi se ky Propozimplan është i bazuar në Planin e Veprimt të Komisionit për Integritet Evropian.

Naser Rugova - Tha se është një propozimplan gjithëpërfshirës dhe konkret. Propozoi të përfshihen më shumë aktivitete të diplomacisë parlamentare. Kërkoj të ketë sqarim më të hollësishëm për mënyrën e shpenzimit të mjeteve, që i ndan Kryesia për komisionet parlamentare.

Edita Tahiri - Propozoi të ketë më shumë aktivitete të diplomacisë parlamentare në muajt e parë të vitit, të vazhdohet promovimi i idesë evropiane nëpër komuna të Kosovës, si dhe të shqyrtohet mundësia e përgatitjes së një publikimi, në të cilin deputetët e Komisionit dalin me shkrime autoriale. Në këtë mënyrë bëhet trashëgimi e Komisionit për brezat që vijnë.

Kryesuesja - Njoftoi se e ka shqyrtuar mundësinë e realizimit të disa vizitave studimore me partnerët, të cilët e mbështesin punën e Komisionit. Shtoi se do të kemi sponsorim nga Komisioni Evropian për dy vizita dhe një nga Projekti i Binjakëzimit, por pretendoj që deri në prill t'i realizojmë katër vizita.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Miratohet njëzëri Propozimplanin i punës i Komisionit me propozimet e deputetëve.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja - referuese e këtij projektligji - Shtoi se në mbështetje të Divizionit për Standardizim është shqyrtuar ky projektligj. Konsideroi se mund të procedohet tutje, sepse kjo fushë është e rregulluar në nivel kombëtar.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja – E ftoi deputetin Naser Rugova ta paraqiste raportin për përputhshmërinë e Projektligjit dhe të amendamenteve të tij për përputhshmërinë me parimet themelore të *Acquis communautaire*.

Naser Rugova - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kemi shqyrtuar këtë projektligj, me amendamente dhe konsiderojmë se mund të procedohet tutje, sepse është në përputhshëri të plotë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.

5. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Projektligjit për borxhet publike, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja - referuese e këtij projektligji - Shtoi se në mbështetje të Divizionit për Standardizim, është shqyrtuar ky projektligj. Konsideroi se mund të procedohet tutje, sepse kjo fushë është e rregulluar në nivel kombëtar.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Projektligjit për borxhet publike, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.

b). Shqyrtimi i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja – E ftoi deputeten Njomza Emini ta paraqiste raportin për përputhshmërinë e Projektligjit dhe të amendamenteve të tij lidhur për përputhshmërinë me parimet themelore të *Acquis communautaire*.

Njomza Emini - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kemi shqyrtuar këtë projektligj, me amendamente dhe konsiderojmë se mund të procedohet tutje, sepse është në përputhshëri të plotë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.

c). Shqyrtimi i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja – E ftoi deputetin Naser Rugova ta paraqiste raportin për përputhshmërinë e Projektligjit dhe të amendamenteve të tij për përputhshmërinë me parimet themelore të *Acquis communautaire*.

Naser Rugova - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kemi shqyrtuar këtë projektligj, me amendamente dhe konsiderojmë se mund të procedohet tutje, sepse kjo fushë rregullohet me legjislacionin kombëtar.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.

d). Raportimi lidhur me përmbushjen e Planit të Veprimit nga komisionet parlamentare

Naser Rugova - Në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural njoftoi se i ka ftuar dy ministrat në një mbledhje të përbashkët dhe ka kërkuar nga ta që në periudha tremujore të raportojnë me shkrim për 6 sfidat që i mbulojnë këto ministri. Lidhur me sfidën e gjashtë tha se kanë qenë dy ligje kontestuese, të cilat besojmë se do të procedohen deri në fund të janarit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50 min.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisioneve

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi